



Republika Kosova
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH.nr.713/20
729/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të: Z. Blerim Dina - Kryetar, Z. Nuhi Paçarizi - Referues, Z. Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik “Multi Business Group” SH.P.K -Prizren dhe “Nabs” SH.P.K & “Detas D.O.O.-Prishtinë, kundër njoftimit për anulim të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Instalimi i ndriçimit publik dhe riparimi i ndriçimit publik ekzistues në Komunën e Prizrenit”, me nr. të prok: 622-20-2058-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- “KK-Prizren”, me datën 12.11.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHEN, si të bazuara ankesat e operatorëve ekonomik “Multi Business Group” SH.P.K -Prizren dhe “Nabs” SH.P.K & “Detas D.O.O.-Prishtinë, kundër njoftimit për anulim të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Instalimi i ndriçimit publik dhe riparimi i ndriçimit publik ekzistues në Komunën e Prizrenit”, me nr. të prok: 622-20-2058-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- “KK-Prizren”.

II. ANULOHET, njoftimi për anulim për aktivitetin e prokurimit me titull “Instalimi i ndriçimit publik dhe riparimi i ndriçimit publik ekzistues në Komunën e Prizrenit”, me nr. të prok: 622-20-2058-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- “KK-Prizren”, dhe lënda të kthehet në **Rivlerësim**.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesat e operatorëve ekonomik ankues: “Multi Business Group” SH.P.K -Prizren, dhe “Nabs” SH.P.K & “Detas D.O.O.-Prishtinë, aprovohen si të bazuara, i’u bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

AR SYETIM

Operatorët ekonomik ankues “Multi Business Group” SH.P.K -Prizren, dhe “Nabs” SH.P.K & “Detas D.O.O.-Prishtinë, si palë të pa kënaqura kanë deponuar ankesë në OSHP, me 25.09.2020 me nr. 713/20, dhe me 25.09.2020 me nr. 729/20, kundër njoftimit për anulim të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Instalimi i ndriçimit publik dhe riparimi i ndriçimit publik ekzistues në Komunën e Prizrenit”, me nr. të prok: 622-20-2058-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- “KK-Prizren”, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 6, 7, 59, 60, 62 dhe 72 të LPP-së, si dhe nenin 44.5 të RRUOPP-së, te ankesa me nr. 713/20.
- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 7, 59, 64, 66, dhe 69 të LPP-së, te ankesa me nr. 729/20.

Organi Shqyrtues i Prokurimit konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 19.10.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palëve ankimore.

Eksperti shqyrtues/teknik i prokurimit në raportin e dt: 28.10.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues “Multi business Group” SH.P.K- Prizren.

Përgjigje në Pretendimi nr. 1, Lidhur me pretendimin e OE ankues se autoriteti kontraktues ka eliminuar pa të drejte ofertën e tyre, me arsyetimin se Certifikata ISO EN sipas kërkesës ne Specifikimet teknike te detyrueshme, nuk janë paraqitur te gjitha certifikatat e kërkuara për produktet e ofertuar dhe mungojnë diplomat për një pjesë të stafit, eksperti shqyrtues ka këtë mendim. Në dosjen e tenderit, respektivisht në FDT te kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale janë kërkuara dhe ISO certifikatat për produktet e

ofruara sipas specifikimit teknike te detyrueshëm. Autoriteti kontraktues ne letrën standarde për eliminim qe i ka dërguar OE ankues i shkruan se nuk janë paraqitur te gjitha certifikatat e kërkuara për produktet e ofruara. Ne këtë letër nuk përmenden konkretisht cilat certifikata mungojnë. Po ashtu ne këtë letër nuk përmenden konkretisht për cilin staf mungojnë diplomat që janë kërkuar në dosje të tenderit. Meqenëse kjo kërkesë e dosjes së tenderit është në kuadër të pikave dhe kërkesave që parashihen në nenin 69 të LPP-së, autoriteti kontraktues ka mundet ti kërkoj operatorit ekonomik ankues për ti plotësuar këto dokumente bazuar në nenin 72 të LPP-së pika 2 që thotë: “Autoriteti kontraktues mund të ftojë operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësojë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të këtij ligji”. Mirëpo, autoriteti kontraktues nuk e ka shfrytëzuar këtë mundësi ligjore për plotësimin e dokumenteve te munguara te OE ankues, siç janë certifikatat ISO dhe diplomat e kualifikimit për stafin e prezantuar por apriori e ka bërë eliminimin e operatorit ekonomik ankues si tenderues i pa përgjegjshëm. Mbi këtë bazë vlerësoj se pretendimi i OE ankues është i bazuar.

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues “Nabs SH.P.K & Detas D.o.o”-Prishtinë

Përgjigje në Pretendimi nr. 1, Lidhur me pretendimin e OE ankues se autoriteti kontraktues ka eliminuar pa të drejte me arsyetimin se mungojnë projektet e natyrës së kontratës të realizuara në tri vitet e shkuara dhe referencat për këto projekte të kërkuara sipas pikës 9.1&9.2 të FDT-së edhe pse ne me ofertë kemi bashkangjitur listën e projekteve dhe referencat për kryerjen e këtyre projekteve, eksperti shqyrtues ka këtë mendim. Ne ofertën që operatori ekonomik ankues te ngarkuar ne platformën elektronik janë të bashkangjitur edhe disa referenca të cilat sipas listës janë të theksuar edhe në ankesën e dorëzuar në OSHP. Sqarimi i autoritetit kontraktues i dhënë ne vendimin e datës 17.09.2020 qe ka nxjerre si përgjigje ne kërkesën për rishqyrtim nuk është i drejte. Ne këtë vendim theksohet se nuk janë pranuar referencat e partnerit të konzorciumit Detas Dleds të OE ankues sepse partneri në fjalë është prodhues i produkteve dhe referencat janë për furnizimet që i ka bërë për palët e treta dhe nuk janë referenca për punë të kryera.

Vetë aktiviteti i prokurimit të AK-së është kontratë për shërbim dhe jo kontratë për punë. Edhe kërkesa ne dosje ka qene për kontrata te natyrës se ngjashme. Referencat e ofruara janë për kontrata te kësaj natyre. Për mendimin e ekspertit shqyrtues, referencat në fjalë e plotësojnë kërkesën e dosjes së tenderit. Përveç këtyre referencave te dhëna ne ankese përmes një table, OE ankues ka dorëzuar edhe një prej referencave për një kontratë të ngjashme që ka pasur me vetë autoritetin kontraktues. Kërkesa e dosjes nuk e ka specifikuar sa referenca duhet të jenë. Në total lista e referencave të dorëzuara nga OE ankues për mendimin e ekspertit shqyrtues janë të pranueshme për këtë aktivitet të prokurimit sepse janë të natyrë së ngjashme. Mbi këtë bazë ky pretendim ankimor vlerësohet si i bazuar.

Mendimi i ekspertit shqyrtues : Autoriteti kontraktues gjatë procesit të ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të ofertave në këtë aktivitet të prokurimit ka eliminuar si të pa përgjegjshëm operatorin ekonomik ankues “Multi business Group” për pikat të cilat sipas dispozitave të nenit 59 dhe 72 të LPP-se kanë mundur të plotësohen me dokumente valide. Po ashtu gjatë këtij vlerësimi është eliminuar edhe OE ankues “Nabs SHPK & Detas D.o.o” i cili bashkangjitur ofertës i ka poseduar referencat për projekte të natyrës së ngjashme. AK nuk ka respektuar në tërësi dispozitat e nenit 59 dhe 72 të LPP-së kur ka eliminuar si të pa përgjegjshëm dy operatorët ekonomik ankues. Si rrjedhojë e kësaj procedure rezulton që AK ka bërë anulimin e aktivitetit në kundërshtim me dispozitat e neni 62 të LPP-se.

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesat e operatorëve ekonomik ankues të aprovohen si të bazuara. Eksperti shqyrtues në përputhje me nenin 114 pika 2 të LPP-së, rekomandon autoritetin kontraktues që ta bëjë **Rivlerësimin** e ofertave për aktivitetin e prokurimit “Instalimi i ndriçimit publik dhe riparimi i ndriçimit publik ekzistues në Komunën e Prizrenit” me nr. prok. 622-20-2058-211, në përputhje me dispozitat e LPP-së.

Organi shqyrtues i prokurimit i ka njoftuar palët me datë: 28.10.2020 me raportin e ekspertizës.

Autoriteti Kontraktues me datë 29.10.2020, me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik “Nabs” SH.P.K.- dhe “Detas D.O.O.- Prishtinë me datë 02.11.2020, me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 12.11.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit, ankesat e operatorëve ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues të prokurimit dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Lidhur me pretendimin e OE ankues “Multi business Group” SH.P.K- Prizren, se autoriteti kontraktues ka eliminuar pa të drejtë ofertën e tyre, me arsyetimin se Certifikata ISO EN sipas kërkesës në Specifikimet teknike të detyrueshme, nuk janë paraqitur të gjitha certifikatat e kërkuara për produktet e ofertuar dhe mungojnë diplomat për një pjesë të stafit.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se në dosjen e tenderit, respektivisht në FDT te kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale janë kërkuara dhe ISO certifikatat për produktet e ofruara sipas specifikimit teknike të detyrueshëm. Autoriteti kontraktues në letrën standarde për eliminim që i ka dërguar OE ankues, i shkruan se nuk janë paraqitur të gjitha certifikatat e kërkuara për produktet e ofruara. Në këtë letër nuk përmenden konkretisht cilat certifikata mungojnë. Po ashtu, në këtë letër nuk përmenden konkretisht për cilin staf mungojnë diplomat që janë kërkuar në dosje të tenderit. Meqenëse kjo kërkesë e dosjes së tenderit është në kuadër të pikave dhe kërkesave që parashihen në nenin 69 të LPP-së, autoriteti kontraktues duhet ti kërkoj operatorit ekonomik ankues për ti plotësuar këto dokumente bazuar në nenin 72 të LPP-së pika 2 që thotë: “Autoriteti kontraktues mund të ftojë operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësojë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të këtij ligji”. Mirëpo, autoriteti kontraktues nuk e ka shfrytëzuar këtë mundësi ligjore për plotësimin e dokumenteve të munguara të OE ankues, siç janë certifikatat ISO dhe diplomat e kualifikimit për stafin e prezantuar por apriori e ka bërë eliminimin e operatorit ekonomik ankues si tenderues i pa përgjegjshëm. Mbi këtë bazë, pretendimi i OE ankues është i bazuar.

Lidhur me pretendimin e **OE ankues “Nabs SH.P.K & Detas D.o.o”-Prishtinë**, se autoriteti kontraktues ka eliminuar pa të drejte me arsyetimin se mungojnë projektet e natyrës së kontratës të realizuara në tri vitet e shkuara dhe referencat për këto projekte të kërkuara sipas pikës 9.1&9.2 të FDT-së edhe pse ne me ofertë kemi bashkangjitur listën e projekteve dhe referencat për kryerjen e këtyre projekteve.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se në ofertën që operatori ekonomik ankues të ngarkuar në platformën elektronike janë të bashkangjitur edhe disa referenca, të cilat sipas listës janë të theksuar edhe në ankesën e dorëzuar në OSHP. Sqarimi i autoritetit kontraktues i dhënë në vendimin e datës 17.09.2020 që ka nxjerr si përgjigje në kërkesën për rishqyrtim nuk është i drejtë. Në këtë vendim theksohet se nuk janë pranuar referencat e partnerit të konzorciumit Detas Dleds të OE ankues sepse partneri në fjalë është prodhues i produkteve dhe referencat janë për furnizimet që i ka bërë për palët e treta dhe nuk janë referenca për punë të kryera. Vetë aktiviteti i prokurimit të AK-së është kontratë për shërbim dhe jo kontratë për punë. Edhe kërkesa në dosje ka qenë për kontrata të natyrës së ngjashme. Referencat e ofruara janë për kontrata të kësaj natyre. Pra, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se referencat në fjalë e plotësojnë kërkesën e dosjes së tenderit.

Përveç këtyre referencave të dhëna në ankesë përmes një table, OE ankues ka dorëzuar edhe një prej referencave për një kontratë të ngjashme që ka pasur me vetë autoritetin kontraktues. Kërkesa e dosjes nuk e ka specifikuar sa referenca duhet të jenë. Në total lista e referencave të dorëzuara nga OE ankues janë të pranueshme për këtë aktivitet të prokurimit sepse janë të natyrës së ngjashme. Pra, ky pretendim ankimor vlerësohet si i bazuar.

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe sqarimeve të ekspertit shqyrtues, konsideron se autoriteti kontraktues gjatë procesit të ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të ofertave në këtë aktivitet të prokurimit ka eliminuar si të pa përgjegjshëm operatorin ekonomik ankues “Multi business Group” për pikat të cilat sipas dispozitave të nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së mund të plotësohen me dokumente valide. Po ashtu, gjatë këtij vlerësimi është eliminuar edhe OE ankues “Nabs SHPK & Detas D.o.o” i cili bashkangjitur ofertës i ka poseduar referencat për projekte të natyrës së ngjashme. Andaj, Paneli Shqyrtues sqaron se AK nuk ka respektuar në tërësi dispozitat e nenit 59 dhe 72 të LPP-së kur ka eliminuar si të pa përgjegjshëm dy operatorët ekonomik ankues. Si rrjedhojë e kësaj procedure rezulton që AK ka bërë anulimin e aktivitetit në kundërshtim me dispozitat e neni 62 të LPP-së.

Andaj, obligohet AK që gjatë rivlerësimit të tenderëve të kërkoj sqarime shtesë konform nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.



Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK “KK-Prizren”;
- 1x1 OE “Multi Business Group”- SH.P.K-Prizren;
- 1x1 OE “Nabs” SH.P.K., & “Detas D.O.O.-Prishtinë;
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.